



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Ngjyra Org. Org. Jedrinica Org. Limit	SP-02
Nr. Prot. Org. Prot. Prot. No.	1978-2/26
Nr. i faqes Broj. stranic No. pages	04
Data Datum Date:	18.06.26
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	16.06.2026
REFERENC-Ë:	26/1978/386/ DMM
PËR/ZA/TO:	"Solariss" L.L.C. Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korrigjim Vendimi



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën e pranuar nga nga kompania e juaj për korrigjimin e Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me nr.prot.: 23/2081/191/DMM të datës 25.09.2023 dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për korrigjimin e Vendimit për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Solariss" L.L.C. Prishtinë, për Parkun e Energjisë Diellore, në ngastrat kadastrale: 00001-1, 00001-8, 00001-13, 00001-14, 00019-10, 00019-11, 00002-38, 00004-3, 00004-5, 00004-14 dhe 00004-21, Z.K. Kosuriq, Komuna e Pejë.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me nenin 17 të Rregullores (QRK) Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Korrigjohet Vendimi i Pëlqimit Mjedisor me nr.prot.: 23/2081/191/DMM të datës 25.09.2023 dhe miratohet kërkesa e Kompanisë "Solariss" L.L.C. Prishtinë për zvogëlim të kapaciteteve nga 140 MW_{AC}/123 MW_{AC} në 107.9 MW_{AC}/99 MW_{AC}, po ashtu i mbeten në vendim vetëm ngastrat kadastrale: 00001-1, 00001-8, 00001-13, 00001-14, 00019-10, 00019-11, 00002-38, 00004-3, 00004-5, 00004-14 dhe 00004-21, Z.K. Kosuriq, Komuna e Pejë.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës me nr. protok. 24/2493-3/DMM, të datës 15.05.2026 të Kompanisë "Solariss" L.L.C. Prishtinë, për korrigjimin e Vendimit për Pëlqim Mjedisor me nr.prot.: 26/1978/386/ DMM të datës 16.04.2026, është konstatuar se kërkesa për revidim/zvogëlim të kapacitetit të prodhimit ka të bëjë me vendimin për kushte ndërtimore nr. 2130/24 të datës 27.08.2024 si dhe kërkesën e KOSTT-it,

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



pasi që Marrëveshja e kyçjes së lejuar nga KOSTT Sh.A. ka ndërruar kapacitetet nga 140 MW_{AC}/123 MW_{AC} në 107.9 MW_{AC}/99 MW_{AC}

Meqenëse ngastrat dhe koncepti i projektit mbeten të pa ndryshuar dhe nuk kemi të bëjmë me ndonjë ndryshim nga koncepti ideor i projektit dhe rrethanat dhe kushtet e përcaktuara në Pëlqim Mjedisor mbesin të njëjta, duke u mbështetur në paragrafin 1, neni 50, të Ligjit nr. 05/L-031, për procedurën e Përgjithshme Administrative, aprovohet kërkesa për korrigjim të Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me nr.prot.: 23/2081/191/DMM të datës 25.09.2023, për kompaninë "Solariss" L.L.C. Prishtinë.

Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 26/1978/ / - ZSP/ /26 datë: 02.06.2026
Prishtinë



Bajram Kafexholli

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Pejës
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPHI

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

